



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË**  
**NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot .

Datë .05.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Materiale elektrike”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

- Materiale elektrike (31681410-0)

**VLERA E FONDIT LIMIT: 5,107,470 (pesë milion e njëqind e shtatë mijë e katërqind e shtatëdhjetë) lekë PA TVSH**

**Autoriteti kontraktor ka llogaritur fondin limit duke u bazuar ne manualin e cmimeve ne perputhje me parashikimet ligjore te nenit 76, paragrafi pare pika a) ,të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Ndermarrja e Sherbimeve Publike, Bashkia Korçë**ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

## 2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare: **2021, 2022, 2023**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës .

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 paragrafi 2 pika b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

*Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros te jete jo më e vogel se vlera e fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2b te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne: *nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nëzbatimtëLigjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat",I ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5,datë 30.01.2006,"Për tatimin mbi të ardhurat",I ndryshuar,VKM-së Nr.922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore,vetëm nëpërmjet formes elektronike",si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

## 2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **35 %** të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet , për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

- Autoriteti/enti kontraktor përpara fazes së nënshkrimit të kontratës duhet t’i dergojë kërkesë në rrugë elektronike (email zyrtar) ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njëjsuara me origjinalin.
- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimit e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

### 2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

#### 2.3.1. Operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë :

- a) Operatori duhet të paraqesë jo më vonë se data dhe ora e hapjes së tenderit **mostrat** e materialeve të më poshtme të cilat duhet të jenë sipas specifikimeve teknike:

Nr	Emertimi i materialeve	Njesia	Sasia
1	Llamba Led 220V 26 W E 27 4000k	cope	1
2	Llamba led 8W, E27, 3000K	cope	1
3	Llamba led 8W, E27, 4000K	cope	1
4	Portollamba porcelani E 27	cope	1

5	Kabell bakri me izolim PVC 2x2.5 mm <sup>2</sup>	ml	1
6	Kabell bakri me izolim PVC 3x2.5 mm <sup>2</sup>	ml	1
7	Kabell bakri me izolim PVC 4x10 mm <sup>2</sup>	ml	1
8	Kabell bakri me izolim PVC 4x16 mm <sup>2</sup>	ml	1
9	Përcjellës alumini $\phi$ 16mm ,PVC,me dy përcjellës, linjë ajrore	ml	1
10	Përcjellës alumini $\phi$ 16 mm PVC, me një përcjellës, linjë ajrore	ml	1
11	Përcjellës tokëzimi bakri $\phi$ 10 mm	ml	1
12	Automat 40 A, 1P, 220 V	copë	1
13	Konektorë I linjes kryesore	copë	1
14	Konektorë abonenti	copë	1
15	Qafore për ndriçuesit rrugor	copë	1
16	Tirantues	copë	1
17	Tokëzues l=1.5m	copë	1
18	Tube fleksibël 50 mm me fije brenda	ml	1
19	Rele kohe	copë	1
20	Izolant	copë	1
21	Drozel 150W,230V	copë	1

Mostrat duhet të dorëzohen jo më vonë se data dhe ora e hapjes së tenderit. Mos dorëzimi i mostrave brenda afatit do të sjellë skualifikimin e operatorit pjesëmarrës.

**Mostrat do të dorëzohen pranë zyrës së protokollit - arkivit të Ndermarrjes së Sherbimeve Publike, Bashkia Korçë jo më vonë se data dhe ora e hapjes së procedurës së prokurimit.**

#### Argumentimi:

Kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e *mostrave të mallit* është përcaktuar proporcionalisht dhe në përputhje me objektin e kontratës, bazuar në nenin 77, të LPP, si dhe nenin 40, par.6, pika a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe është vendosur me qëllim që Autoriteti Kontraktor të vlerësojë përputhshmerinë e mallrave me standartet teknike si dhe për të garantuar cilësinë dhe origjinalitetin e mallrave.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

- **Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

**Termet e references,sasite,specifikimet teknike jane hartuar nga personat pergjegjes per hartimin e specifikimeve teknike caktuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Nr. 181 date 24.05.2024.**

**Ato jane si me poshte:**

Specifikimi i Materialeve:

<b>Nr</b>	<b>Emertimi i materialeve</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>
<b>1</b>	Llamba Led 220V 26 W E 27 4000k	copë	100
<b>2</b>	Llamba led 8W,E27,3000K	copë	500
<b>3</b>	Llamba led 8W,E27,4000K	copë	500
<b>4</b>	Portollamba porcelani E27	copë	200
<b>5</b>	Kabëll bakri me izolim PVC 2x2.5 mm2	ml	400
<b>6</b>	Kabëll bakri me izolim PVC 3x2.5 mm2	ml	900
<b>7</b>	Kabëll bakri me izolim PVC 4x10 mm2	ml	1,200
<b>8</b>	Kabëll bakri me izolim PVC 4x16 mm2	ml	500
<b>9</b>	Përcjelles alumini φ 16 mm, PVC me dy percjellsa,linje ajrore	ml	1,500
<b>10</b>	Përcjelles alumini φ 16 mm, PVC me një percjellë,linje ajrore	ml	5,000
<b>11</b>	Përcjellës tokëzimi bakri φ 10 mm	ml	100
<b>12</b>	Automat 40A,1P, 220V	copë	50
<b>13</b>	Konektor I linjës kryesore	copë	1,500
<b>14</b>	Konektor abonenti	copë	1,500
<b>15</b>	Qafore për ndriçues rrugor	copë	1,500
<b>16</b>	Tirantues	copë	1,500
<b>17</b>	Tokezues l=1.5m	copë	20
<b>18</b>	Tube fleksibël φ 50 mm, me fije brenda	ml	1,590
<b>19</b>	Rele kohe	copë	20
<b>20</b>	Izolant	copë	540
<b>21</b>	Drozel 150W,230V	cope	30

## **SPECIFIKIME TEKNIKE**

### **1.Llambe led 26W E 27 4000K.**

Burimit dritës:

LED


Fuqia

26W

Portollamba	<b>E 27</b>
Jetëgjatësia:	jo më pak se 25.000 orë pune
Color Temperature:	4000K
Tensioni:	220 – 240 V
Frekuenca	50-60Hz
Temperatura Operimit:	-35 <sup>0</sup> C deri në +40 <sup>0</sup> C
Indeksi Renderimit Ngjyrës:	70
Eficensa lm/W:	≥ 160 lm/W
Fluksi ne lm OUT:	≥4160 lm (+/-2%)
Permasat	≤ 210x38x38 mm

### **2,3- LLAMBE LED 8w, 3000 K /4000 K, E27**

#### **Te jete e ngjashme me modelin e paraqitur**

Burimit dritës:	LED	
Materjali i llambes	plastik	
Portollamba	<b>E 27</b>	
Fuqia	8 W	
Jetëgjatësia:	jo më pak se 15.000 orë pune	
Color Temperature:	3000K/4000K	
Tensioni:	220 – 240 V	
Frekuenca	50-60Hz	
Indeksi Renderimit Ngjyrës:	80	
Eficensa lm/W:	≥ 100 lm/W	
Fluksi ne lm OUT:	≥800 lm	
Temperatura e ambientit	-20 <sup>0</sup> C deri +45 <sup>0</sup> C	

## 5,6,7,8- Kabllot

Kabllot e përdorur do të jenë të tipit FG16OR16, sipas normës CEI 20-13, kabëll fleksibël bakri me izolim në gomë G16, veshje të jashtme me material termoplastik, me lëshim shumë të ulët të gazrave toksike. Përdoren në instalimet elektrike me rrezikshmëri zjarri ku është thleshësore mbrojtja e njerëzve nga gazrat toksikë, si shkolla, spitale, hotele, kinema, teatër, supermarkete, zyra, ambiente publike, etj.

Kabllot FG16OR16 është kabllot HEPR fleksibël, i izoluar, me mburojë të endur, të përberë prej përcjellësish me bakër të kuq, me mbrojtje PVC, antikorroziv dhe pa halogjen. Është i përshtatshëm për transmetimin e fuqisë dhe kontrollin e fuqisë në industri dhe ndërtim. I përshtatshëm për instalime fikse të brendshme dhe të jashtëme, instalime në ura, në tuba, etj.

Standartet:

- CEI 20-13, CEI 20-11, CEI 20-29, IEC 60502-1, CEI UNEL 35375,
- CEI UNEL 35377 - CEI 20-22 II, CEI EN 60332-1-2 – Cilësi të larta antizjarr.



- CEI EN 50267-2-1 – Antikorroziv

Të gjitha duhet të kenë vetinë që nuk ndihmojnë zjarrin e nuk prodhojnë gaze helmuese gjatë vetëdjegies.

### Karakteristikat teknike:

- |                                    |          |
|------------------------------------|----------|
| -Tensioni nominal                  | 0,6/1 KV |
| -Tensioni maksimal                 | 1200 V   |
| -Temperatura e punës               | 90° C    |
| -Temperatura në lidhje të shkurtër | 250° C   |

Fusha e përdorimit: Kabëll për transmetim energjie, për montim në ambiente të jashtme të lagura.

Të jenë të markuara me markat e cilësisë IMQ ose CE .

### Seksionet e kabllave që kërkohen:

2x2.5mm<sup>2</sup> / 3x2.5mm<sup>2</sup> / 4x10mm<sup>2</sup> / 4x16 mm<sup>2</sup>

## 9,10-Përcjelles alumini Φ 16 mm PVC, me dy dhe një përcjellës, për linjë ajrore

Me shume fije

Me mbulesa plastike

Tensioni nominal 0.6/1 kv

Temperatura e punës 900° C

Të jetë për ambiente të jashtme me lagështirë.

Të ketë tregues për gjatesinë në çdo metër me bojë të dukshme.

### 11- Percjelles tokezimi bakri s=10mm<sup>2</sup>

Me veshje PVC, kundër zjarrit,

tension pune : 450/750V,

në përputhje me standartet EN 50575:2014 dhe A1:2016 dhe

Rregullores së Komunitet European Nr.305/201.



### 12. Automatet 1 Polare me rrymë 6– 40 A duhet të kenë këto karakteristika teknike:

Tipi magnetotermik

Normë e referimit CEI EN 60898

Versioni 1P+N

Karakteristika magnetotermike C

Rrymat nominale në 30°C 6 – 40 A

Tensioni nominal 230 V

Tensioni nominal i mbajtjes së impulsit 4 KV

Tensioni i izolacionit 500 V

Frekuenca nominale 50 – 60 Hz

Fuqia nominale e shkëputjes së qarkut të shkurtër 4,5 KA

Temperatura e punës -25° deri 60 °C

Numri maksimal i manovrave elektrike 10.000 cikle

Numri maksimal i manovrave mekanike 20.000 cikle

Grada e proteksionit IP20/ IP40

Seksioni maksimal i kabllimit 25 mm<sup>2</sup>



### 13-Konektorë

Te gjitha materialet duhet te jene konform standarteve me te fundit IEC ose ekuivalenteve te



tyre( si psh VDE 0211, VDE 0220,NFC 330 20 etj, per nyjet lidhese; VDE 0211, NF C 33 042 e tje per tirantuesit e kabllit ABC) .

Te gjitha materialet Fe duhet te jene te galvanizuar ne te nxehte ose sic specifikohet konkretisht ne materialin me poshte.

### **Nyje lidhese te izoluara(konektore) te pa depertueshme nga uji(waterproof)**

STANDARD: EN 50483

Konektori është projektuar për degëzimin dhe vazhdimin e linjave kryesore kabllore ABC kryesisht për sherbimet ne ndriçim.

Gjatë montimit dhe instalimit, izolimi i linjave kryesore dhe degëve nuk duhet të hiqet. Kontaktet e tyre duhet te jene projektua prej materiali qe te lejoje lidhjen elektrike ne percjellsa prej alumini dhe bakri. Bulloni shtrengues duhet te jete i paisur me kapuc izolues. Gjate shtrengimit te bulonit “dhembet” duhet te levizin drejt percjellsave te izoluar, diametralisht poshte dhe lart, duke u futur fillimisht ne pjesen e izolimit te percjellsave, duke e depertuar ate dhe pastaj ne brendesi te materialit te percjellsave. Gjithashtu ky shtrengim nuk duhet te zvogeloje qendrushmerine mekanike te percjellsave. Pjeset plastike izoluese duhet te jene prej polimeresh te perforcuara me fibra xhami dhe rezistente ndaj rezatimit ultraviolet

**1-Konektori per linjen kryesore** eshte projektuar per te realizuar lidhjen elektrike te magjistralit dhe te degezimeve te linjes me percjelles alumini me vetembajtje me te njejtin seksion, pa e hequr izolimin e percjellsave


Tensioni i testimit:	6kV/50Hz për 1 min.
Seksioni I linjës kryesore:	<b>16-95 mm<sup>2</sup></b>
Diametri i linjës kryesore	7.0-15.7 mm
Seksioni I linjes se degës :	<b>16-95 mm<sup>2</sup></b> (Aluminum max)
Diametri i linjës së degës :	7.0-15.7 mm
Çift rrotullues shtrengues :	AL-15 Nm / PL-18Nm

Dimensionet:

a [mm]  $59 \pm 2$  mm

b [mm]  $38 \pm 2$  mm

H [mm]  $78 \pm 2$  mm



Materiali i kontaktit: Aliazh alumini

Bulon 1 x M8

Veshje: e galvanizuar

Trupi dhe izoluesi: Poliamid rezistent ndaj motit dhe UV-së dhe elastomer i papërshkueshëm nga uji

Dado me kokë ndarëse: aliazh alumini, 13 mm


Kapaku izolues: elastomer rezistent ndaj rrezeve ultraviolet dhe motit

Rondele: çeliku

## 14. Konektor abonenti

### Ilustrimi

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



### Karakteristika

Nyja lidhese e izoluar per abonentin **eshte projektuar per te realizuar lidhjen elektrike te percjellsave te linjes me percjelles alumini me vetembajtje me percjellsat e linjes qe furnizojne abonentin, pa e hequr izolimin e percjellsave.** Ne kete menyre nuk lihen ne percjellsat kryesore dhe ata te abonentit, pjese percjellese te zhveshura. Kontaktet e tyre duhet te jene projektuar prej materiali qe te lejoje lidhjen elektrike ne percjellsa prej alumini dhe bakri. Bulloni shtrengues duhet te jete i paisur me kapuc izolues. Gjate shtrengimit te bulonit “dhembet” duhet te levizin drejt percjellsave te izoluar, diametralisht poshte dhe lart, duke u futur fillimisht ne pjesen e izolimit te percjellsave, duke e depertuar ate dhe pastaj ne brendesi te materialit te percjellsave.. Gjithashtu ky shtrengim nuk duhet te zvogeloje qendrushmerine mekanike te percjellsave. Pjeset plastike izoluese duhet te jene prej polimeresh te perforcuara me fibra xhami dhe rezistente ndaj rezatimit ultraviolet

Nyja lidhese izoluese eshte paisur me kapuc te izoluar .

### Zbatimi

Nyja lidhese e izoluar abonentit sherben për të realizuar lidhjen elektrike të përcjellësve të linjës me përcjellës alumini me vetembajtje me përcjellësit e linjës të cilat furnizojnë abonentin(pergjithesisht nje fazor).

STANDARD: EN 50483

### Parametra Teknike

- Tensioni i testimit: 6kV/50Hz për 1 min.
- **Linja kryesore (seksioni): 6-95 mm<sup>2</sup>**

- Diametri i linjës kryesore 4.6-15.7 mm
- **linja e deges(seksioni): 1.5-16 mm<sup>2</sup>**
- Diametri i linjës së degës : 3.0-7.0 mm


Çift rrotullues shtrëngues 7 Nm

Dimensionet:

a [mm]  $38 \pm 1$  mm

b [mm]  $41 \pm 1$  mm

H [mm]  $60 \pm 1$  mm



## 15-Qafore për ndriçues rrugor

### . Aksesori Shtyllor (Qafore) për terheqje në dy krahe

Keta projektohen për t'u fiksuar në të "tirantuesit ankerorë të linjes" dhe për të trasmetuar në shtyllë sforcimet mekanike të linjes me përcjelles alumini me vetembajtje.

Materiali Çelik EN 10025, 50x6 mm I galvanizuar në të nxehtë trashësia e galvanizimit jo më e vogël se 60 µm. Të gjitha buzët do të jenë me zmusë (të rumbullakosura).

Qendrueshmëria mekanike e tyre për secilin nga "nyjet" e tij ku fiksohet "tirantuesi ankeror", duhet të jetë jo më pak se 45 kN.

Ilustrimi

(Ilustrimet dhe dimensionet janë orientuese)



- Qafore M 10x60, material çelik

## 16-Tirantues

### -Tirantues ankeror (Tirantues linje)

#### Karakteristika

Aksesori "Tirantues ankeror" për linjat me kabllë alumini me vetembajtje shërben për fiksimin, shtrëngimin dhe qendrueshmërinë e këtyre linjave. Ato janë projektuar për të

realizuar qendrueshmerine e sistemit me katër përcjellës për të gjithë seksionet nga 4x16 mm<sup>2</sup> deri në 4x95 mm<sup>2</sup>.

Trupi metalik i tirantuesit ankeror përbëhet prej çeliku të galvanizuar.

Fiksimi dhe shtrëngimi i përcjellësve të linjës realizohet përmes një pakete polimeri.

Ato janë perforcuar me fibra qelqi; qe janë rezistente ndaj rrezatimit UV; te tipit vete-shtrenguese ku çdo përcjellës ka nga një vrimë. Sistemi i pllakave prej polimeri i fiksohet trupit metalik të tirantuesit ankeror përmes prixhionerëve fiksues.

Per te shmangur sforcimet e pa nevojshme, tirantuesit ankerore jane me krah te levizshem dhe te rotullueshem ne perputhje me drejtimin e orientimit te vete linjes duke krijuar nje cift rotullues. Qendrueshmeria dhe parametrat teknike te “tirantuesave ankeror“ duhet te jene ne plotesim te kerkesave te standarteve nderkombetare VDE 0211/ESI 43-14.

### Zbatimi

Aksesori “**Tirantues ankeror**” për linjat me kablllo alumini me vetembajtje shërben për fiksimin, shtrëngimin dhe qendrueshmerine e këtyre linjave.

#### a. Tipi ne forme pjastre

##### Ilustrimi

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



-Tirante per kapje 4x16-35 mm<sup>2</sup>


-Materjal celik dhe poliamid

-Forca e shtrengimit deri ne 22 Nm.

#### 17- Tokezues (Elektrodat e tokëzimit) l=1.5m

##### Elektrodat e tokëzimit

##### Ilustrimi



## Përshkrimi, Kërkesat dhe Të Dhënat

Ky specifikim mbulon kërkesat për elektrodën e sistemit të tokëzimit. Pjesë perberese e elektrodës është edhe morseta sipas detajit "A"

### TË DHËNA TEKNIKE

Formë kryqi "+" jo më pak se 50x5mm, H=1.5m, që nuk shtrihet/zgjatet


Cilësia e çelikut DIN 17 100

Pajisur me pllakë bashkuese

Pajisur me morseten për bashkimin me percjellesin me diametër deri 13mm

I përputhshëm me DIN 48 - 452

Shtresë zinku - minimumi 70 mikron.



Morseta është e përbërë prej materiali me një qëndrueshmëri shumë të lartë i cili është veshur me një shtresë anti korrozive zinku me një trashësi 60 mikron.

Morseta shtrengohet fort me bulona të cilat kanë një shtresë anti korrozive. Bulonat dhe rrethet janë prej çeliku të galvanizuar në të nxehtë

Elektroda e tokëzimit duhet të jetë xingato, me gjatësi 1.5 m, e kompletuar me morseterine përkatëse.

### 18.-Tuba fleksibel 50 mm me fije Brenda (tubo plastike)

Seksionet e tubave që kërkohen:

Φ 50 mm

Për lidhjen midis pushtave elektrike do të përdoret tub korrugato fleksibel me dy shtesa të cilat do të instalohen nën tokë. Tubi korrugato me dy shtresa polietilen është një tub më dendës të lartë për ruajtjen e kabllave elektrike dhe telefonike nën tokë. Është i përbërë nga dy shtresa. Shtresa e jashtme në formë fleksibel e cila është për rezistencën dhe elasticitetin e tubit, si dhe shtresa e brendshme për kalimin e lehtë të kabllave.

Diametri që do të instalohet duhet të korespondojë me përmasat e paraqitura në vizatimin elektrik. Tubi fleksibel duhet të plotësojë këto kushte:

Kushte: Sigla	FU 15
Normativa	CEI EN 50086-1
Marka e cilësisë	IMQ në cdo 3 m
Materiali	Polietilen



Tubat me 2 shtresa të densiteteve të ndryshme.

Fusha e përdorimit: për impiante nëntokësore të rrjetave elektrike e telekomunikacionit.

Vendosja : nën tokë.

### **19-Rele kohe-E ngjashme me modelin si ne fig.**

Tensioni: 220-240V AC

frekuenca: 45/60Hz

Dalja:10-16A



### **20-Izolant**

Gjatesia e izolantit 1.5 m

**Për të gjitha materjalet e mësipërme të sillen mostra dhe të jenë prodhim I CE.**

**Specifikimet teknike janë hartuar pas verifikimeve të kryera në lidhje me nevojat për materiale elektrike që ka ndermarrja duke u bazuar në nevojat e sektorit .**

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **TERMAT E REFERENCES**

Objekti dhe qëllimi :

**Kjo kontratë ka për qëllim realizimin e furnizimit me materiale elektrike.**

**Kontraktuesi duhet të furnizojë me mallra në përputhje me standartet e kërkuara dhe specifikimet teknike me shpenzimet e tij deri në dorëzimin në vendin e përcaktuar që është magazina e ndermarrjes së Sherbimeve Publike, Bashkia Korçë.**

## Afati

12 (dymbëdhjetë ) muaj nga data e lidhjes se mareveshjes kuader.

Nr	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Llamba Led 220V 26 W E 27 4000k	100 cope	NSHP	12 muaj
2	Llamba led 8W, E27, 3000K	500 cope	NSHP	12 muaj
3	Llamba led 8W, E27, 4000K	500 cope	NSHP	12 muaj
4	Portollamba porcelani E 27	200 cope	NSHP	12 muaj
5	Kabell bakri me izolim PVC 2x2.5 mm <sup>2</sup>	400 ml	NSHP	12 muaj
6	Kabell bakri me izolim PVC 3x2.5 mm <sup>2</sup>	900 ml	NSHP	12 muaj
7	Kabell bakri me izolim PVC 4x10 mm <sup>2</sup>	1,200 ml	NSHP	12 muaj
8	Kabell bakri me izolim PVC 4x16 mm <sup>2</sup>	500 ml	NSHP	12 muaj
9	Përcjellës alumini φ 16mm ,PVC,me dy përcjellësa, linjë ajrore	1,500 ml	NSHP	12 muaj
10	Percjelles alumini φ 16 mm PVC, me një përcjellës, linjë ajrore	5,000 ml	NSHP	12 muaj
11	Përcjelles tokëzimi bakri φ 10 mm	100 ml	NSHP	12 muaj
12	Automat 40 A, 1P, 220 V	50 cope	NSHP	12 muaj
13	Konektorë I linjes kryesore	1,500 cope	NSHP	12 muaj
14	Konektorë abonenti	1,500 cope	NSHP	12 muaj
15	Qafore për ndriçuesit rrugor	1,500 cope	NSHP	12 muaj
16	Tirantues	1,500 cope	NSHP	12 muaj
17	Tokëzues l=1.5m	20 cope	NSHP	12 muaj
18	Tubo fleksibël 50 mm me fije brenda	1,590 ml	NSHP	12 muaj
19	Rele kohe	20 cope	NSHP	12 muaj
20	Izolant	540 cope	NSHP	12 muaj
21	Drozol 150W,230V	30 cope	NSHP	12 muaj

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.Mallrat janë kërkuar sipas sasive dhe nevojave efektive për të përmbushur nevojat e ndërmarrjes në mënyrë të plotë për realizimin e shërbimeve në interes të komunitetit.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,**duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi*

*ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

### **Njesia e prokurimit**